REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit 02
Nr.Prot: / Broj Prot: / Prot.No. 05-31119
Nr.i faqeve / Br.stranica / No.pages -40-
Data: / Datum: / Date: 24/04/2024
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria- Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Nr. 295/IV/2024
Date: 23.04.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), dhe nenit 12 dhe 13 të Rregullores MF-Nr.04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-vë, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte/programe të organizatave jo-qeveritare në fushën e shëndetësisë ndërlidhur me „Promovimin e Shëndetit Mendor, Promovimi dhe Parandalimi i Sëmundjeve Infektive HIV dhe TB si dhe Fuqizimi i të rinjve për jetë të shëndetshme".

I

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Kosovës, kodi ekonomik **200**, në kuadër të programit/nën programit **903.**
3. Organizatat Jo Qeveritare të cilat ofrojnë shërbime shëndetësore duhet të jenë të licencuara në përputhje me Ligjin Nr.04/L-125 për Shëndetësi.

II

1. Mjetet e përmendura në nenin 1 paragrafi 2 do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimi e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përshinë:

   1.1 Teksti i thirrjes publike
   1.2 Udhëzimet për aplikantët
   1.3 Formularët e aplikimit
   1.4 Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
   1.5 Format për raportimin e zbatimit të projektit

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:

   2.1 Forma e përshkrimit të programit apo projektit
   2.2 Forma e buxhetit të programit apo projektit
   2.3 Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta
   2.4 Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme)
   2.5 Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike.

2.6 Deklarata për Aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatim (nëse aplikohet)

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
   3.1 Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
   3.2 Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
   3.3 Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

IV.

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare https://msh.rks-gov.net/.

V.

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuara që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VI.

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.

2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.

3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Departamenti i Zhvillimit Strategjik Shëndetësor.

VII.

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit

Dr. Naim Bardiqi

Sekretar i Përgjithshëm

Vendimi i dërgohet:

- *Kabinetit të Ministrit;*
- *DZHSSH;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Arkivit të MSH-së.*

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria- Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve:

"Promovimi i Shëndetit Mendor, Promovimi dhe Parandalimi i Sëmundjeve Infektive HIV dhe TB si dhe Fuqizimi i të rinjve për jetë të shëndetshme"

---

1. Ministria e Shëndetësisë u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, të aplikojnë për mbështetje financiare me projektet e tyre. Thirrja vlen për OJQ-të programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e shëndetësisë, ndërlidhur më promovimin e Shëndetit Mendor, promovimin dhe parandalimin e sëmundjeve infektive HIV dhe TB si dhe fuqizimi i të rinjve përmes aktiviteteve vetëdijësuese dhe edukuese për jetë të shëndetshme.

2. ~~OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre në njërën~~ nga objektivat specifike si në vijim:

3. *Objektiva Specifike:* **Promovimi i Shëndetit Mendor dhe Parandalimi i Çrregullimeve Mendore**

   - Zhvillimi i aktiviteteve promovuese përmes organizimit të fushatave që rrisin ndërgjegjësimin për zvogëlimin e stigmës dhe që fuqizojnë kujdesit për shëndetin mendor në popullatë;
   - Zhvillimi i aktiviteteve edukuese, informuese për t'i mbështetur personat me ngarkesë emocionale, për të inkurajuar komunikimin e hapur, për ndarjen e emocioneve dhe përvojave;
   - Edukimi lidhur me aktivitete fizike dhe aktivitetet tjera që ndikojnë në të ushqyerit e shëndetshëm dhe në përmirësimin e gjendjes të shëndetit mendor;
   - Zhvillimi i aktiviteteve promovuese për shëndetin mendor te grupet e cenueshme përmes rritjes së njohurive për marrjen e veprimeve të duhura për të përmirësuar shëndetin e tyre;
   - Promovimi dhe informimi rreth sjelljeve të shëndetshme për parandalimin e dukurive negative dhe sjelljeve vetëlënduese/vetëdëmtuese nga profesionistët e licencuar respektivisht të certifikuar për lëmi përkatëse;

- Kritja e vetëdijësimit për ndikimin e traumës dhe reduktimin e stigmës;
- Zhvillimi i aktiviteteve për mbështetjen e personave, inkurajimi i tyre për të kërkuar ndihmë nga specialistët e lëmive përkatëse te institucionet që ofrojnë shërbime profesionale të shëndetit mendor.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt që **Promovimi i Shëndetit Mendor dhe Parandalimi i Çrregullimeve Mendore** është 7,000.00 euro për projekt, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 15,000.00 euro.

Vlera totale e objektives specifike është: 50,000.00 euro.

4. *Objektivat specifike:* **Të mbahet prevalenca e ulët e HIV në mesin e popullatave kyçe, dhe përmirësimi i kualitetit të jetës të personave të afektuar nga HIV, në Kosovë.**

1. Fushata të avokimit dhe promovimit në komunitet për uljen e stigmës dhe diskriminimit te personat që jetojnë me HIV dhe popullatat kyçe;
2. Fushata të avokimit dhe ndërgjegjësimit për të drejtat e personave që jetojnë me HIV dhe për popullatat kyçe;
3. Realizimi i aktiviteteve informuese dhe edukuese me qëllim të promovimit dhe këshillimit rreth testimit për HIV;
4. Organizimi i javës promovuese për rëndësinë e testimeve për HIV në minimum pesë (5) qendra te Kosovës;
5. Fushata të avokimit për testimin vullnetar për HIV, HCV, HBV dhe Sifilis;
6. Avokim të komunitetit për rëndësin e testimit me HIV, me qëllim të zvogëlimit të riskut dhe promovimit të testimit, distribuimin e pakove parandaluese të Përdoruesve Injektues të Drogave, në 7 regjione të Kosovës;
7. Aktivitete të edukimit joformal (të peer-edukimit) për personat që i takojnë popullatave kyçe për HIV;
8. Planifikimi i aktiviteteve për shënimin e ditës Botërore të HIV/AIDS.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për projekt që kontribuon në: **Mbajtjen e prevalences të ulët të HIV në mesin e popullatave kyçe, dhe përmirësimi i kualitetit të jetës të personave të afektuar nga HIV, në Kosovë** është: 8.000 euro për projekt individual, ndërsa shumë maksimale për një projekt është 45,000 euro.

Vlera totale e objektives specifike për HIV për vitin 2024 është: **92,866.00** euro.

5. *Objektivat specifike:* **Forcimi dhe avokimi për sëmundjen e Tuberkulozit/ TB në komunitet.**

1. Realizimi i fushatave ndërgjegjësuese të popullatës në komunat e identifikuara;
2. Krijimi i materialeve ndëgjegjësuese për adherencën (përgjigjien ndaj trajtimit të pacientëve me TB) dhe komunitetit ku jetojnë, duke përfshirë përgatitjen e lefletave, broshurave të vogla për pacientin dhe familjarët për kohëzgjatjen e trajtimit, rëndësinë e marrjes së barnave rregullisht; mënyra se si familjarët ndihmojnë në trajtimin e pacientit me TB etj.
3. Krijimi i materialeve për zbulimin aktiv me TB në komunitet, këshillimit të personave të dyshimtë që të drejtohen te Institucionet publike që ofrojnë shërbime për pacientë me TB;
4. Promovimi dhe avokimi i rëndësisë së kthimit të rasteve aktiv me TB në institucionet publike shëndetësore me qëllim të përforcimit të ndjekjes së rasteve të humbura me TB, si dhe avokimi tek familjarët apo njerëzit e tyre më të afërt që kanë ndikim tek pacienti me qëllim të eleminimit të stigmës ndaj kësaj sëmundje;
5. Avokimi për të drejtën e shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore për personat me TB përmes fushatave promovuese dhe parandaluese për TB, në grupet e rrezikut;
6. Matja e njohurive, qëndrimeve dhe stigmës në komunitet, mbi sëmundjen e TB.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për projekt që ofron aktivitete qe kanë për qëllim: **Forcimin dhe avokimin e sistemeve komunitare të Programit të TB** është: **7000** euro për projekt, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **25,000** euro.

Vlera totale e objektives specifike për HIV për vitin 2024është: **35,000.00** euro.

6. *Objektiva Specifike:* **Fuqizimi i të rinjve me shkathtësi jetësore thelbësore për një jetë të suksesshme e të mirëqenë përmes edukimit joformal cilësor dhe punës rinore cilësore dhe aktiviteteve vetëdijësuese:**

1. Organizimi i kampeve rinore në fushat prioritare të identifikuara (shëndeti mendor, shëndeti riprodhues dhe seksual, varësia nga substancat narkotike, alkooli dhe duhani);
2. Aktivitete vetëdijësuese për shëndetin mendor , shqetësimet lidhur me përballimin e stresit dhe pasojat nga çrregullimet e shëndetit mendor te të rinjët;
3. Aktivitete promovuese për të informuar të rinjët mbi çështjet dhe rëndësinë e shëndetit riprodhues;
4. Realizimi i aktiviteteve informuese për përdorimin e kontraceptivëve dhe rëndësinë e përdorimit të tyre;
5. Aktivitete informuese për rreziqet e shtatzënisë në mosha të hershme;
6. Ofrimi i njohurive për të rinjët rreth dukurive që cënojnë mirëqenien dhe sigurinë e tyre (bullizmi fizik dhe verbal dhe ngacmimet seksuale);
7. Organizimi i fushatave të ndryshme vetëdijësuese për, me, dhe nga të rinjtë, lidhur me dukuritë negative që prekin të rinjtë, si përdorimi i substancave narkotike.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për projekt që kontribuon në: **Fuqizimi i të rinjve me shkathtësi jetësore thelbësore për një jetë të suksesshme e të mirëqenë përmes edukimit joformal cilësor dhe punës rinore cilësore dhe aktiviteteve vetëdijësuese:** është: 7.000 euro për projekt individual, ndërsa shumë maksimale për një projekt është 20,000 euro.

➢ Vlera totale e objektivës specifike për vitin 2024 është ***50, 000* euro**

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria- Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Prishtinë: 24.04.2024

Mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve:
"Promovimi i Shëndetit Mendor, Promovimi dhe Parandalimi i Sëmundjeve Infektive HIV dhe TB si dhe Fuqizimi i të rinjve për jetë të shëndetshme"

Udhëzimet për Aplikantët

Data e hapjes së thirrjes: 24.04.2024

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: 17.05.2024

Përmbajtja

MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-ve **"Promovimi i Shëndetit Mendor, Promovimi dhe Parandalimi i Sëmundjeve Infektive HIV dhe TB si dhe Fuqizimi i të rinjve për jetë të shëndetshme"**

1.1 Problemet të cilat synohet të adresohen përmes kësaj thirrje publike
1.2 Objektivat e thirrjes dhe prioritetet për ndarjen e fondeve
1.3 Vlera e planifikuar të mbështetjes financiare për projektet dhe totali i thirrjes

2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES
2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?
2.2 Partnerët e pranueshme në zbatimin e projektit/programit
2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes
2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes
2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme
2.4.2 Shpenzimet e tërthorta të pranueshme
2.4.3 Shpenzimet e papranueshme

3. SI TË APLIKONI?
3.1 Formulari i aplikacionit të projekt-propozimit
3.2 Përmbajtja e formës Buxhetit
3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin
3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve
3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje

4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE
4.1 Aplikacionet e pranuara do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme
4.2 Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi

5. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES

6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

Thirrje publike për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve: "Promovimi i Shëndetit Mendor, Promovimi dhe Parandalimi i Sëmundjeve Infektive HIV dhe TB si dhe Fuqizimi i të rinjve për jetë të shëndetshme"

1. Problemet të cilat synohet të adresohen përmes kësaj thirrje publike

Ministria e Shëndetësisë synon përmirësimin e shëndetit të popullatës së Republikës së Kosovës përmes sigurimit të qasjes universale dhe të barabartë në shërbimet shëndetësore cilësore për të gjithë qytetarët e vendit. Një nga sfidat në luftimin e sëmundjeve infektive si HIV dhe TB është mungesa e edukimit dhe burimeve gjithëpërfshirëse, veçanërisht në komunitetet. Pavarësisht progresit të rëndësishëm në përparimet mjekësore, shumë njerëzve ende nuk kanë akses në informacionin jetik dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor, duke i lënë ata të prekshëm ndaj këtyre sëmundjeve. Për më tepër, stigma e përhapur që rrethon HIV-in dhe TB-në shpesh i pengon individët të kërkojnë testim dhe trajtim, duke përkeqësuar kështu përhapjen e infeksioneve.

Për të adresuar këto çështje, OJQ-të mund të luajnë një rol të rëndësishëm duke përdorur fushata synuese ndërgjegjësimi si fushata avokuese, promovuese dhe edukuese për sëmundjet infektive si HIV dhe Tuberkulozi (TB) duke i ofruar komuniteve dhe grupeve kyçe informata për t'u drejtuar për marrje të shërbimeve të institucionet shëndetësore, duke shpërndarë materiale edukative apo duke avokuar përpjekjet për parandalimin dhe trajtimin e HIV dhe TB etj. Duke adresuar këto barriera, OJQ-të mund të kontribuojnë ndjeshëm në reduktimin e barrës së sëmundjeve infektive dhe përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së përgjithshme të komuniteteve.

Përmes promovimit, edukimit dhe avokimit për shëndetin mendor synojmë ndërmarrjen e veprimeve për t'i parandaluar çrregullimet mendore, për t'i forcuar aftësitë individuale të individëve që të jetojnë një jetë sa më të shëndetshme më produktive, siç edhe përkufizohet nga OBSh –ja, që shëndeti mendor është një "gjendje e mirëqenies në të cilën individi realizon aftësitë e tij/saj, dhe mund t'i përballojë streset normale të jetës, të punojë në mënyrë produktive dhe të frytshme dhe të jetë në gjendje të kontribuoj për komunitetin e tij/saj".

Po ashtu mungesa e njohurive për domosdoshmërinë dhe mundësinë e përdorimit të kontraceptivëve konsiderohet si faktori kryesor që ndër të tjerash shpie edhe tek shtatzënitë dhe lindjet në moshë të hershme. Të rinjtë gjithnjë e më shumë po përballen me probleme apo çrregullime të ndryshme të shëndetit mendor, të cilat janë rritur dukshëm si pasojë e pandemisë COVID-19. Të rinjtë në Kosovë po ashtu po përballen edhe me dukuri që cenojnë mirëqenien dhe sigurinë e tyre siç janë bullizmi fizik dhe verbal si dhe ngacmimet seksuale (35% e të rinjve të moshës 13-17 vjeçare rezulton se janë ndjerë të bullizuar ose të ngacmuar gjatë vitit të kaluar). Prandaj është shumë e rëndësishme pajisja e të rinjve me shkathtësi jetësore përmes edukimit joformal dhe aktiviteteve vetëdijësuese.

Duke çmuar lartë rolin e shoqërisë civile, Ministria e Shëndetësisë synon vazhdimin e bashkëpunimit me Organizata joqeveritare që në kuadër të fushëveprimit të tyre kanë të vendosur edhe sektorin e shëndetësisë.

Ministria e Shëndetësisë, gjatë vitit 2024 planifikon që përmes thirrjes publike të ofrojë mbështetje financiare për implementimin e projekteve të organizatave Jo-Qeveritare në fushën e shëndetësisë me prioritetet: **"Promovimi i Shëndetit Mendor, Promovimi dhe Parandalimi i Sëmundjeve Infektive HIV dhe TB si dhe Fuqizimi i të rinjve për jetë të shëndetshme"**

1.1 Objektivat e thirrjes dhe prioritetet për ndarjen e fondeve:

Objektivat e përgjithshme të kësaj janë:

- Promovimi i Shëndetit Mendor dhe Parandalimi i Çrregullimeve Mendore
- Të mbahet prevalenca e ulët e HIV në mesin e popullatave kyçe, dhe përmirësimi i kualitetit të jetës të personave të afektuar nga HIV, në Kosovë
- Forcimi dhe avokimi për sëmundjen e Tuberkulozit/ TB në komunitet
- Fuqizimi i të rinjve me shkathtësi jetësore thelbësore për një jetë të suksesshme e të mirëqenë përmes edukimit joformal cilësor dhe punës rinore cilësore dhe aktiviteteve vetëdijësuese

Objektivat specifike të thirrjes janë:

- Zhvillimi i aktiviteteve promovuese përmes organizimit të fushatave që rrisin ndërgjegjësimin për zvogëlimin e stigmës dhe që fuqizojnë kujdesin për shëndetin mendor në popullatë;
- Zhvillimi i aktiviteteve edukuese, informuese për t'i mbështetur personat me ngarkesë emocionale, për të inkurajuar komunikimin e hapur, për ndarjen e emocioneve dhe përvojave;
- Edukimi lidhur me aktivitete fizike dhe aktivitetet tjera që ndikojnë në të ushqyerit e shëndetshëm dhe në përmirësimin e gjendjes të shëndetit mendor;
- Zhvillimi i aktiviteteve promovuese për shëndetin mendor të grupet e cenueshme përmes rritjes së njohurive për marrjen e veprimeve të duhura për të përmirësuar shëndetin e tyre;
- Promovimi dhe informimi rreth sjelljeve të shëndetshme për parandalimin e dukurive negative dhe sjelljeve vete lënduese/vete dëmtuese nga profesionistët e licencuar respektivisht të certifikuar për lëmi përkatëse;
- Rritja e vetëdijesimit për ndikimin e traumës dhe reduktimin e stigmës;
- Zhvillimi i aktiviteteve për mbështetjen e personave, inkurajimi i tyre për të kërkuar ndihmë nga specialistët e lëmive përkatëse te institucionet që ofrojnë shërbime profesionale të shëndetit mendor;
- Fushata të avokimit dhe promovimit në komunitet për uljen e stigmës dhe diskriminimit te personat që jetojnë me HIV dhe popullatat kyçe;
- Fushata të avokimit dhe ndërgjegjësimit për të drejtat e personave që jetojnë me HIV dhe për popullatat kyçe;

- Realizimi i aktiviteteve informuese dhe edukuese me qëllim të promovimit dhe këshillimit rreth testimit për HIV;
- Organizimi i javës promovuese për rëndësinë e testimeve për HIV në minimum pesë (5) qendra te Kosovës;
- Fushata të avokimit për testimin vullnetar për HIV, HCV, HBV dhe Sifilis;
- Avokim të komunitetit për rendësin e testimit me HIV, me qëllim të zvogëlimit të riskut dhe promovimit të testimit, distribuimin e pakove parandaluese të Përdoruesve Injektues të Drogave, në 7 regjione të Kosovës;
- Aktivitete të edukimit joformal (të peer-edukimit) për personat që i takojnë popullatave kyçe për HIV;
- Planifikimi i aktiviteteve për shënimin e ditës Botërore të HIV/AIDS;
- Realizimi i fushatave ndërgjegjësuese të populatës në komunat e identifikuara;
- Krijimi i materialeve ndëgjegjësuese për adherencën (përgjigjien ndaj trajtimit të pacientëve me TB) dhe komunitetit ku jetojnë, duke përfshirë përgaditja e lefletave, broshurave të vogla për pacientin dhe familjarët për kohëzgjatjen e trajtimit, rëndësinë e marrjes së barnave rregullisht, mënyra se si familjarët ndihmojnë në trajtimin e pacientit me TB etj.
- Krijimi i materialeve për zbulimin aktiv me TB në komunitet, këshillimit të personave të dyshimtë që të drejtohen te Institucionet publike që ofrojnë shërbime për pacientë me TB;
- Promovimi dhe avokimi i rëndësisë së kthimit të rasteve aktiv me TB në institucionet publike shëndetësore me qëllim të përforcimit të ndjekjes së rasteve të humbura me TB, si dhe avokimi tek familjarët apo njerëzit e tyre më të afërt që kanë ndikim tek pacienti me qëllim të eleminimit të stigmës ndaj kësaj sëmundje;
- Avokimi për të drejtën e shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore për personat me TB përmes fushatave promovuese dhe parandaluese për TB, në grupet e rrezikut;
- Matja e njohurive, qëndrimeve dhe stigmës në komunitet, mbi sëmundjen e TB;
- Organizimi i kampeve rinore në fushat prioritare të identifikuara (shëndeti mendor, shëndeti riprodhues dhe seksual, varësia nga substancat narkotike, alkooli dhe duhani);
- Aktivitete vetëdijësuese për shëndetin mendor, shqetësimet lidhur me përballimin e stresit dhe pasojat nga çrregullimet e shëndetit mendor te të rinjtë;
- Aktivitete promovuese për të informuar të rinjtë mbi çështjet dhe rëndësinë e shëndetit riprodhues;
- Realizimi i aktiviteteve informuese për përdorimin e kontraceptivëve dhe rëndësinë e përdorimit të tyre;
- Aktivitete informuese për rreziqet e shtatzënisë në mosha të hershme;
- Ofrimi i njohurive për të rinjtë rreth dukurive që cenojnë mirëqenien dhe sigurinë e tyre (bullizmi fizik dhe verbal dhe ngacmimet seksuale);
- Organizimi i fushatave të ndryshme vetëdijësuese për, me, dhe nga të rinjtë, lidhur me dukuritë negative që prekin të rinjtë, si përdorimi i substancave narkotike.

1.2 Vlera planifikuar e mbështetjes financiare për projektet dhe totali i thirrjes

Për financimin e projekteve sipas kësaj Thirrje publike është paraparë shuma në vlerë prej: **227,866.00** euro.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt që kontribuon në: **"Promovimi i Shëndetit Mendor dhe Parandalimi i Çrregullimeve Mendore"** është 7,000.00 euro, ndërsa shuma maksimale për projekt është: 15,000.00 euro.

Vlera totale e objektives specifike është: **50,000.00 euro.**

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për projekt që kontribuon në: **"Mbajtjen e prevalences të ulët të HIV në mesin e popullatave kyçe, dhe përmirësimi i kualitetit të jetës të personave të afektuar nga HIV, në Kosovë"** është: **8,000.00** euro, ndërsa shumë maksimale për një projekt është: **45,000.00** euro.

Vlera totale e objektives specifike për është: **92,866.00 euro.**

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për projekt që kontribuon në **"Forcimin dhe avokimin e sistemeve komunitare të Programit të TB"** është: **7,000.00** euro, ndërsa shuma maksimale për projekt është: **25,000.00** euro.

~~Vlera totale e objektives specifike është: 35,000.00 euro.~~

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për projekt që kontribuon në: **"Fuqizimi i të rinjve me shkathtësi jetësore thelbësore për një jetë të suksesshme e të mirëqenë përmes edukimit joformal cilësor dhe punës rinore cilësore dhe aktiviteteve vetëdijësuese"** është: **7,000.00** euro për projekt, ndërsa shumë maksimale për projekt është: **20,000.00** euro.

Vlera totale e objektives specifike është **50, 000.00 euro.**

2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

2.1 Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?

- OJQ-të aplikuese të regjistruara, për të dëshmuar këtë kërkesë, OJQ-ja aplikuese duhet të paraqesë kopjen e certifikatës së regjistrimit me rastin e aplikimit;
- Të jetë e pajisur me numër fiskal, të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës. Me rastin e aplikimit OJQ-duhet të dëshmojë këtë kërkesë përmes kopjes së certifikatës së numrit fiskal;
- Të kenë të kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit, OJQ-ja me rastin e aplikimit duhet të dorëzoj formën e deklarimit të projekteve apo programeve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike të financimit;
- OJQ-ja aplikuese nuk duhet të ketë pranuar mjete financiare për realizimin e të njëjtave aktivitete në vitin përkatës fiskal. Prandaj, me rastin e aplikimit kërkohet një deklaratë e cila e shmangë financimin e dyfishtë për aktivitetet e njëjta;
- Të mos ekzistoj ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit dhe të organizatës buxhetore apo institucionit publik siç parashihet ne legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;
- ~~Organizatat Jo Qeveritare të cilat ofrojnë shërbime shëndetësore duhet të jenë të licencuara~~ në përputhje me Ligjin Nr.04/L-125 për Shëndetësi;
- Të ketë zotësi juridike, financiare dhe operacionale për zbatimin e projektit;
- Të ketë kryer të gjitha detyrimet tatimore dhe kontributet tjera të detyrueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;
- Të dorëzojnë brenda afatit të thirrjes projekt propozimin i cili ndër të tjera përmban të dhënat për qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të dhënat tjera sipas formularit përkatës të përcaktuar sipas thirrjes publike;
- Projekt propozimi të jetë i shoqëruar me një propozim buxhet, sipas formatit të përcaktuar sipas thirrjes publike dhe Manualit për zbatimin e kësaj Rregulloreje;
- Të dorëzojë të dhëna për stafin kyç (menaxherin, ekspertet e angazhuar duke siguruar CV-të dhe certifikatat/ licencën, për rastet kur kërkohet);
- Të sigurojnë dëshmi e duhur për projektet për të cilat kërkohet bashkëfinancim, nëse është e aplikueshme;

- Të dëshmojnë se kanë përvojë në realizimin e aktiviteteve sipas thirrjes publike, së paku 1 vit;

- Të ofrojnë së paku 1 referencë për realizimin e projekteve/programeve për fushat sipas thirrjes publike;

- Të mos jetë në proces falimentimi, në proces të shuarjes, në procedura të mbledhjes së detyrueshme apo likuidimit;

- Të mos ketë shkelur kushtet e parashikuar të përdorimit të fondeve publike.

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërën nga kriteret e përgjithshme dhe specifike, aplikimi konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

2.2 Nuk kanë të drejtë për të konkurruar sipas kësaj thirrje:

OJQ-të të cilat nuk përmbushin kriteret e përgjithshme dhe kriteret specifike përcaktuara në pikën 2.1 të këtij udhëzuesi si dhe në nenin 10 dhe 11 të Rregullores MF-Nr - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, nuk mund të aplikojnë për mbështetje financiare, ose në rast aplikimi, dosja e tyre nuk do të merret për bazë në fazën e shqyrtimit dhe nuk do të kualifikohen për mbështetje financiare.

2.3 Numri i projekteve me të cilat mund të aplikoj një OJQ:

OJQ-të mund të aplikojnë ose të jenë partner ne më së shumti vetëm në një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje publike.

2.4 Partnerët e pranueshme në zbatimin e projektit/programit

Për zbatimin e projektit nuk është e detyrueshme ekzistenca e partneritetit me organizata të tjera por e njëjta është e dëshirueshme.

Në rast të ekzistencës së partneritetit, partnerët mund të marrin pjesë më së shumti një aplikim si partner dhe një projekt si bartës.

Partnerët duhet të përmbushin të gjitha kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për aplikuesit, siç është paraparë në pikën 2.1 të këtyre udhëzimeve.

Me rastin e aplikimit, aplikuesi duhet të ketë arritur marrëveshje të partneritetit me OJQ-të partnere. Për këtë qëllim duhet nënshkruar një deklaratë e partneritetit (sipas formularit të

publikuar), e cila duhet të dorëzohet në kopje origjinale të nënshkruar nga secili partner në projekt.

2.5 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

Periudha e zbatimit

- **Periudha e zbatimit të projektit është 6 muaj.**

Shtrirja gjeografike e zbatimit

- Projektet mund të zbatohen në terë teritorin e Republikës së Kosovës

Llojet kryesore të aktiviteteve që do të financohen përmes thirrjes:

- Aktiviteteve qe kanë për qëllim promovimin e Shëndetit Mendor dhe Parandalimi e Çrregullimeve Mendore;
- Të mbahet prevalenca e ulët e HIV në mesin e popullatave kyçe, dhe përmirësimi i kualitetit të jetës të personave të afektuar nga HIV, në Kosovë;
- Aktivitete qe rrisin forcimin dhe avokimin për sëmundjen e Tuberkulozit/ TB në komunitet;
- Fuqizimi i të rinjve me shkathtësi jetësore thelbësore për një jetë të suksesshme e të mirëqenë përmes edukimit joformal cilësor dhe punës rinore cilësore dhe aktiviteteve vetëdijësuese.

2.6 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

Përmes fondeve publike të kësaj thirrje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit/programit do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

Kostoja e buxhetuar duhet të jetë reale dhe duhet të jetë e orientuar drejt kostos më efektive për arritjen e rezultateve të pritshme të aktivitetit të propozuar. Kostot e pranueshme janë kostot reale të Aplikuesit të cilat përmbushin të gjitha kriteret e mëposhtme:

2.7 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme

Shpenzimet sipas kostove të pranueshme direket përfshijnë shpenzimet që janë direkt të lidhura me zbatimin e aktiviteteve të projektit ose të programit të propozuar të tilla si:

- Zhvillimi i aktiviteteve promovuese përmes organizimit të fushatave që rrisin ndërgjegjësimin për zvogëlimin e stigmës dhe që fuqizojnë kujdesit për shëndetin mendor në popullatë;
- Zhvillimi i aktiviteteve edukuese, informuese për t'i mbështetur personat me ngarkesë emocionale, për të inkurajuar komunikimin e hapur, për ndarjen e emocioneve dhe përvojave;
- Edukimi lidhur me aktivitete fizike dhe aktivitetet tjera që ndikojnë në të ushqyerit e shëndetshëm dhe në përmirësimin e gjendjes të shëndetit mendor;
- Zhvillimi i aktiviteteve promovuese për shëndetin mendor te grupet e cenueshme përmes rritjes së njohurive për marrjen e veprimeve të duhura për të përmirësuar shëndetin e tyre;
- Promovimi dhe informimi rreth sjelljeve të shëndetshme për parandalimin e dukurive negative dhe sjelljeve vete lënduese/vete dëmtuese nga profesionistët e licencuar respektivisht të certifikuar për lëmi përkatëse;
- Rritja e vetëdijesimit për ndikimin e traumës dhe reduktimin e stigmës;
- Zhvillimi i aktiviteteve për mbështetjen e personave, inkurajimi i tyre për të kërkuar ndihmë nga specialistët e lëmive përkatëse te institucionet që ofrojnë shërbime profesionale të shëndetit mendor;
- Fushata të avokimit dhe promovimit në komunitet për uljen e stigmës dhe diskriminimit te personat që jetojnë me HIV dhe popullatat kyçe;
- Fushata të avokimit dhe ndërgjegjësimit për të drejtat e personave që jetojnë me HIV dhe për popullatat kyçe;
- Realizimi i aktiviteteve informuese dhe edukuese me qëllim të promovimit dhe këshillimit rreth testimit për HIV;
- Organizimi i javës promovuese për rëndësinë e testimeve për HIV në minimum pesë (5) qendra te Kosovës;
- Fushata të avokimit për testimin vullnetar për HIV, HCV, HBV dhe Sifilis;
- Avokim të komunitetit për rendësin e testimit me HIV, me qëllim të zvogëlimit të riskut dhe promovimit të testimit, distribuimin e pakove parandaluese të Përdoruesve Injektues të Drogave, në 7 regjione të Kosovës;
- Aktivitete të edukimit joformal (të peer-edukimit) për personat që i takojnë popullatave kyçe për HIV;
- Planifikimi i aktiviteteve për shënimin e ditës Botërore të HIV/AIDS.
- Realizimi i fushatave ndërgjegjësuese të popullatës në komunat e identifikuara;
- Krijimi i materialeve ndëgjegjësuese për adherencën (përgjigjën ndaj trajtimit të pacientëve me TB) dhe komunitetit ku jetojnë, duke përfshirë përgaditja e lefletave, broshurave të vogla për pacientin dhe familjarët për kohëzgjatjen e trajtimit, rëndësinë e marrjes së barnave rregullisht, mënyra se si familjarët ndihmojnë në trajtimin e pacientit me TB etj.

- Krijimi i materialeve për zbulimin aktiv me TB në komunitet, këshillimit të personave të dyshimtë që të drejtohen te Institucionet publike që ofrojnë shërbime për pacientë me TB;
- Promovimi dhe avokimi i rëndësisë së kthimit të rasteve aktiv me TB në institucionet publike shëndetësore me qëllim të përforcimit të ndjekjes së rasteve të humbura me TB, si dhe avokimi tek familjarët apo njerëzit e tyre më të afërt që kanë ndikim tek pacienti me qëllim të eleminimit të stigmës ndaj kësaj sëmundje;
- Avokimi për të drejtën e ofrimit/sigurimit të shërbimeve shëndetësore për personat me TB përmes fushatave promovuese dhe parandaluese për TB, në grupet e rrezikut;
- Matja e njohurive, qëndrimeve dhe stigmës në komunitet, mbi sëmundjen e TB.
- Organizimi i kampeve rinore në fushat prioritare të identifikuara (shëndeti mendor, shëndeti riprodhues dhe seksual, varësia nga substancat narkotike, alkooli dhe duhani);
- Aktivitete vetëdijësuese për shëndetin mendor , shqetësimet lidhur me përballimin e stresit dhe pasojat nga çrregullimet e shëndetit mendor te të rinjët;
- Aktivitete promovuese për të informuar të rinjët mbi çështjet dhe rëndësinë e shëndetit riprodhues;
- Realizimi i aktiviteteve informuese për përdorimin e kontraceptivëve dhe rëndësinë e përdorimit të tyre;
- Aktivitete informuese për rreziqet e shtatzënisë në mosha të hershme;
- Ofrimi i njohurive për të rinjët rreth dukurive që cenojnë mirëqenien dhe sigurinë e tyre (bullizmi fizik dhe verbal dhe ngacmimet seksuale);
- Organizimi i fushatave të ndryshme vetëdijësuese për, me, dhe nga të rinjtë, lidhur me dukuritë negative që prekin të rinjtë, si përdorimi i substancave narkotike.
- Shpenzimet e pagave dhe pagesave për menaxherët e projektit/programit, të kontraktorëve të projektit nga organizatat dhe partnerët e përfshirë në projekt, duke specifikuar kategoritë e profesionistëve të angazhuar, numrin e muajve të angazhimit dhe shumën mujore bruto të kompensimit;
- Shpenzimet e komunikimit (shpenzimet e telefonit, internetit, etj) këto shpenzime duhet të jenë të përcaktuara dhe mund të financohen deri në 10% e shumë së fondeve të aprovuara nga Komisioni;
- Shpenzimet e transportit dhe derivateve, të cilat janë të planifikuara për qëllim të ngrohjeve apo vizitave në teren dhe familje (varësisht prej llojit të projektit, mund të lejohen deri ne 10% e shumës së fondeve të aprovuara nga Komisioni);
- Kosto tjera që nuk bëjnë pjesë në listën e shpenzimeve të papranueshme, të cilat janë të domosdoshme për zbatimin e aktiviteteve të projektit(varësisht prej llojit të projektit mund të lejohen deri në 10% e shumës së fondeve të aprovuara nga Komisioni).

2.6 Shpenzimet e tërthorta të pranueshme

Përveç shpenzime të pranueshme direket, në kuadër të kësaj thirrje do të pranohen edhe kostot indirekte (20% e vlerës totale të projektit/programit). Në kuadër të këtyre shpenzimeve përfshihen kostot që nuk janë të lidhura direkt me zbatimin e projektit ose programit, por janë kosto që në mënyrë të tërthortë kontribuojnë në arritjen e objektivave të projektit. Edhe këto kosto duhet të specifikohen dhe të shpjegohen në formularët e aplikacionit të projektit, buxhetit dhe formularët tjerë.

2.8 Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë:

- Taksat, shpenzimet e interesit për borxhin dhe kamatat;
- Blerja, marrja me qira ose dhënia me qira e tokës dhe ndërtesave ekzistuese;
- Investimet në kapital apo kredi për investime, fonde të garancisë;
- Kostot e blerjes së pajisjeve, mobileve dhe punëve të vogla renovim(vetëm kostot e blerjeve dhe renovimeve të vogla mund të jenë të pranueshme deri në 10% e totalit të mbështetjes se aprovuar nga Komisioni);
- Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e procedurave gjyqësore;
- Pagesat e bonuseve për punonjësit;
- Detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive, tarifat për transfertat financiare dhe tarifat e tjera krejtësisht të një natyre financiare;
- Kostot që tashmë janë të financuara nga burime publike apo shpenzime në periudhën e projektit të financuar nga burime të tjera;
- Blerja e pajisjeve të përdorura, makineri dhe mobile etj;
- Kostot që nuk mbulohen nga marrëveshja (kontrata me ofruesin e mbështetjes financiare);
- Donacionet bamirëse;
- Kredi për organizata të tjera apo individ;
- Kostot e tjera që nuk janë të lidhura direkt me përmbajtjen dhe objektivat e projektit.

3. SI TË APLIKONI?

Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

- Formulari i Projekt-propozimit i nënshkruar dhe vulosur, **obligative;**
- Formulari i Propozim buxhetit i nënshkruar dhe vulosur, **obligative;**
- Formulari i Deklaratës së partneritetit **obligative** nëse ka partneritet;
- Forma e Deklaratës të mungesës së financimit të dyfishtë, **obligative**

- Forma e deklarimit të projekteve apo programeve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike të financimit, **obligative**;
- Kopja e Certifikatës së regjistrimit të OJQ-së; **obligative**;
- Kopja e Certifikatës së Numrit Fiskal, **obligative**;
- Deklarata e dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore të deklaruara në ATK (formulari CD) për vitin 2023, **obligative**;

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-ja duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës në lidhje me gjendjen e obligimeve apo borxhit publik të aplikuesit dhe partnerëve që vërteton së organizata nuk ka borxh publik apo ka ndonjë marrëveshje për shlyerje të obligimeve apo borxhit publik.

